



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E RREHIT GJYQËSOR DURRËS**

---

<b>Numri i Ceshtjes :</b>	71041-01809-11-2017	<b>Data e Regjistrimit :</b>	08/11/2017
<b>Numri i Vendimit:</b>	11-2018-1671	<b>Data e Vendimit :</b>	10/04/2018

**VENDIM**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

**GJYKATA E RREHIT GJYQËSOR DURRËS E PËRBËRË NGA:**

**GJYQTAR:** Rexhep Bekteshi

**SEKRETARE:** Brunilda Dizdari

Sot më datë 10/04/2018mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :

Kërkues {...}, i biri i {...} dhe i x, i datëlindjes {...}

**Objekti:**Kundërshtim i vendimit të sekuestros pranë bankave datë 20.09.2017 i Prokurorit së Rrethit Gjyqësor Durrës z.Edmond Koloshi.

**Baza Ligjore:**Neni 212, 274, 276 i K.Pr.Penale, neni 42 i Kushtetutës.

Në gjykim mori pjesë **Prokurori i çështjes Edmond Koloshi.**

Gjykata shqyrtoi materialet e çështjes si dhe provat e paraqitura në gjykim që u administruan në seancë gjyqësore dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dëgjoi kërkuesin {...} dhe avokaten mbrojtëse të tij Alketa Kajmaku **që i kërkuan**

**Gjykatës:**

-Shfuqizimin dhe heqjen e masës së sekuestros të vendosur me Vendimin penal të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, i datës 20.09.2017, "Sekuestrim pranë bankave" për llogaritë personale të {...}i, i datëlindjes {...}, si dhe të {...}

-person fizik me NIPT {...}, pranë bankës "{...}" sh.a., në zbatim të neneve 210 e 212 të Kodit Procedurës Penale.

Prokurori i çështjes Edmond Koloshi në përfundim të shqyrtimit gjyqësor deklaroi se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës po kryhen hetime për veprën penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" në bazë të nenit 287 të Kodit Penal dhe janë kryer shumë veprime hetimore mbi të cilat është mbështetur dhe vendimi i datës 20.09.2017 "Sekuestrimi pranë bankave" të llogarive së shtetasit, personit nën hetim {...}.

Prokurori i çështjes shtoi se veprimtaria kriminale e mësipërme lidhet me Shoqërinë "{...}." me administrator shtetasin {...} për të cilën Prokuroria ka zgjeruar hetimet në bashkëveprim nga autoritetet hetimore italiane dhe për shkaqet e mësipërme i kërkoi Gjykatës të rrëzojë kërkesën e bërë nga kërkuesi {...}.

**VEREN :**

## Vëren:

Se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal Nr. 1714, datë 20.09.2017, për veprën penale të "Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" në bazë të nenit 287 të Kodit Penal në ngarkim të personit nën hetim {...}, me banim në Durrës.

Rezultoni se personi nën hetim {...} ka lidhur Kontratën e Qirasë me Nr. 3601 Rep. e Nr. 1233 Kol., datë 07.09.2017 me Shoqërinë "{...}" me administrator shtetasin italian {...}, i datëlindjes {...}, me qëndrim {...}Itali.

Ai i ka dhënë me qera shtetasit italian të mësipërm ullahte, me sipërfaqe totale 3091 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Zonën Kadestrale 3385, Vol. 10, Fq. 78, sipas çertifikatës së pronësisë të datës 30.06.2005, si dhe vreshta me sipërfaqe totale 1.000 m<sup>2</sup>, Zona Kadestrale 3385, Vol. 2, Fq. 250, sipas çertifikatës së pronësisë datë 04.10.2005. Afati i qerases është përcaktuar për një periudhë kohore prej Euro për sipërfaqen prej 4091 m<sup>2</sup>, për çdo vit, dhe 600.000

Euro për 4 vjet dhe se pagesat do të kryhen në llogarinë bankare të personit nën hetim {...}, pranë "{...} Bank" sh.a.

Është përcaktuar se sipërfaqja e mësipërme nga Shoqëria "{...}" me administrator shtetasin{...}

, do të përdoret për aktivitet privat, parkim, shërbime të ndryshme dhe vendosje impiantesh energjie e shitje të saj (energjisë).

Nga hetimet e kryera janë siguruar të dhëna e fakte se veprimi i mësipërm është kryer për qëllime të paligjshme, për pastrim të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale në bashkëpunim me shtetasin{...} Itali, vepër penale e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Në vazhdim të hetimeve është konstatuar se personi nën hetim {...} më datë 11.03.2015, ka çelur (hapur) një llogari individuale në lëkë tek Banka "{...}", ndërsa më datë 31.07.2017, ai ka çelur llogari rrjedhëse në "Euro" me Nr. {...} te Banka "{...}" si person fizik "{...}" me NIPT {...}, dhe **ka rezultuar se:**

Më datë 15.08.2017, ai ka përfituar një transfertë në vlerën {...} Euro, nga Shoqëria "{...}" me administrator shtetasin italian {...}, me përshkrimin "invoice Nr. {...}."

Më datë 18.08.2017, ka tërhequr {...} Euro me përshkrimin "për biznes".

Më datë 21.08.2017, kanë mbërritur dhe dy transfertat të tjera nga i njëjti urdhërues "{...}" në vlerën përkatësisht {...} Euro dhe {...} Euro me përshkrime përkatësisht "invoice {...}" dhe "invoice nr. {...}", e gjendja e llogarisë më datë 15.09.2017 është {...} Euro.

Nga hetimet e kryera del se në lidhje me 3 transfertat e datës 15 dhe 21.08.2017, për subjektin {...}-Person Fizik me NIPT {...}, sipas përshkrimit në faturat justifikuese të transfertave të fondeve në favor të personit nën hetim {...} janë faturuar prej tij "Kolektor për energjinë diellore efikase, për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar që sipas faturave mall me një matëse "m2" dhe çmimi 50 Euro për njësi.

Faturat e shitjes janë letër e plotësuar dhe printuar nga personi fizik {...} dhe nuk janë fatura shitje sipas formularëve të miratuara zyrtarisht dhe personi nën hetim {...} ka shtuar si objekt veprimtarie jo "shitjen e kolektor për energjinë diellore efikase për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar", por "konsulenca për bojlerë diellorë".

Gjithashtu nga hetimet e kryera del se personi nën hetim {...} ka refuzuar të depozitojë në bankë kontratën e marsit 2017, me shoqërinë që ka transferuar fondet dhe nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 08.09.2017 ka vepruar për të justifikuar se fondet ishin në funksion të qiradhënies së pasurive (vresht dhe ullahte) shoqërisë "{...}" me administrator shtetasin {...}

Rezultoni se personi nën hetim {...} ka deklaruar se transferuat kanë ardhë gabimisht në llogarinë e shoqërisë me NIPT {...}, pasi duhet të vinin në llogarinë personale (pagesë qeraje) megjithëse vërtetohet se ai vetë ka hartuar dhe dërguar faturat e shitjes.

Gjithashtu del se për faktet e mësipërme D.P.P.P.-Parave Tiranë me Urdhërin Nr. 97, datë 18.09.2017 për "Bllokimi i përkohshëm i transaksioneve" është urdhëruar bllokimi i llogarisë bankare në Bankën "{...}" në emër të personit nën hetim {...} dhe si person fizik me NIPT {...}.

Për shkaqet e mësipërme me Vendimin e datës 20.09.2017 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur sekuestrimin e shumave të depozituara në llogarinë bankare në Bankën "{...}" në emër të shtetasit {...}, i datëlindjes {...}, si dhe {...} si Person Fizik me NIPT {...}

Më datë 08.11.2017, personi nën hetim {...} ka paraqitur në Gjykatë kërkesën (ankimin) dhe ka kërkuar shfuqizimin dhe heqjen e masës së sekuestros të vendosur me vendimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, të datës 20.09.2017, të vendosur për llogaritë bankare të tij pranë Bankës "{...}" sh.a.

Në seancë gjyqësore prokurori i çështjes Edmond Koloshi sqaroi se janë kryer hetime për veprën penale të "Pastrim të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" ndaj personit nën hetim {...}. Ai shtoi se veprimtaria kriminale lidhet me Shoqërinë "{...}" me administrator shtetasin {...}, për të cilin Prokuroria ka zgjeruar hetimet në bashkëpunim me autoritetet hetimore italiane.

Gjykata shqyrtoi materialet e çështjes dhe konkludon se vendimi penal i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, i datës 20.09.2017 "Sekuestrimi pranë bankave" i shumave të depozituara në llogarinë bankare në Bankën "{...}" në emër të personit nën hetim {...} dhe ai si Person Fizik me NIPT {...}, është i mbështetur në prova e fakte dhe i domosdoshëm për realizimin e një hetimi të plotë e objektiv të çështjes penale e sigurimin e provave për veprën penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale" e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, dhe për shkaqet e mësipërme kërkesa e bërë nga kërkuesi (ankuesi) {...} duhet rrëzuar.

## Për këto arsye

### Baza Ligjore:

Në zbatim të neneve 210 e 212 të Kodit Procedurës Penale, Gjykata:

## VENDOSI:

Vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit (Ankuesit){...} për shfuqizimin dhe heqjen e masës së sekuestros të vendosur me Vendimin penal të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, të datës 20.09.2017 "Sekuestrim pranë bankave", për llogaritë bankare të kërkuarit {...} pranë Bankës "{...}" sh.a.
  2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Durrës brenda 10 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së tij.
- U shpall sot më datë 10.04.2018.**

#### **SHPENZIMET GJYQESORE**

<b>Kërkesëpadia</b>	0
<b>Taksa Gjyqësore</b>	0
<b>Noterizime</b>	0
<b>Njoftime</b>	0
<b>Akt ekspertimi</b>	0
<b>Avokat</b>	0
<b>Gjithsej</b>	0

**GJYQTAR:**

**Rexhep Bektashi**